




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PRISHTINË - A



Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në përputhje me nenin 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës Nr.06/L-055, Ligjin për Gjykatat Nr.06/L-054, Ligjin Nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, Rregulloren Nr. 03/2021 Për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Gjyqtarëve dhe Vendimit KGJK-së Nr. 45/2024 të datës 22 shkurt 2024, shpall:

### KONKURS PUBLIK PËR POZITËN

#### GJYQATAR

TRIDHJETË E DY (32) POZITA  
për gjyqtarë në nivel të Gjykatave themelore  
dhe Gjykatën Komerciale - dhomat e shkallës së parë

#### REKRUTIMI I KANDIDATËVE PËR GJYQATAR

- Këshilli, përmes këtij njoftimi publik, fton të gjithë profesionistët e kualifikuar ligjor që të aplikojnë për pozitën e gjyqtarit në Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës.
- Me rastin e rekrutimit të një kandidati, Këshilli, në mes tjerash do të marrë parasysh kriteret si në vijim:

#### KRITERET DHE KUALIFIKIMET

- Kandidatët për t'u emëruar gjyqtar, siç parashihet në nenin 104 dhe nenin 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duhet plotësuar kushtet e përgjithshme si në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- të ketë diplomën e Fakultetit Juridik të vlefshme në Republikën e Kosovës;
- të ketë të kryer provimin e Jurisprudencës të pranuar sipas ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës;
- të ketë reputacion të lartë profesional dhe integritet personal;

- të mos jetë i dënuar për veprë penale, me përjashtim të veprave penale të kryera nga pakujdesia;
- të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune në fushën juridike; si dhe
- të ketë kaluar provimin për gjyqtar, në pajtim me kushtet dhe procedurat e përcaktuara me rregulloren 03/2021 të miratuar nga Këshilli.

#### DOKUMENTET E NEVOJSHME

Kandidatët në pajtim me Rregulloren 03/2021 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Gjyqtarëve, duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- Aplikacionin e plotësuar me të dhënat e kërkuara;
- Certifikatën e shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- Diplomën e Fakultetit Juridik të vlefshme në Republikën e Kosovës;
- Certifikatën e provimit të jurisprudencës, të pranuar sipas ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës;
- Certifikatën nga evidenca penale, e lëshuar nga gjykata;
- Certifikata shëndetësore për vlerësimin e aftësive psiko-fizike të kandidatit; si dhe
- Dëshminë mbi përvojën e punës në fushën juridike, siç është përcaktuar në Ligjin për Gjykatat;

Informatat e siguruar nga punëdhënësi për së paku tri (3) vite të përvojës profesionale në fushën juridike, të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen në: përshkrimin e detyrave të punës, performancën profesionale, masat disiplinore dhe çështjet tjera që konsiderohen relevante për procesin, të shoqëruara edhe me dokumente mbështetëse, për vlerësimin e integritetit personal dhe aftësive profesionale, siç parashihen me rregullore dhe me dispozitat e ligjeve të aplikueshme.

Kandidati mund të dorëzojë edhe dokumentet si në vijim:

- Publikime profesionale apo akademike; dhe/ose
- Informata për pjesëmarrje në trajnime.

#### MËNYRA E APLIKIMIT

Aplikacioni së bashku me dokumentet mbështetëse mund të dorëzohet në Zyrën e pranimit në Sekretariatit e KGJK-së :

- në formë fizike (i cili regjistrohet dhe secili kandidat pajiset me një konfirmim mbi pranimin e aplikacionit) dhe
- përmes postës së rregullt

#### NJOFTIM I RËNDËSISHËM PËR KANDIDATËT

I. Neni 10 paragrafi 6 i rregullores 03/2021 përcakton se procesit të rekrutimit kanë të drejtë t'i nënshtrohen vetëm kandidatët e regjistruar në Këshill, në afatin e paraparë me konkurs për aplikim dhe dokumentacion të kompletuar. Ndërsa, kandidatët të cilët nuk kanë aplikuar brenda afatit të paraparë në konkurs, si dhe ata të cilët kanë aplikuar në afat, por nuk e kanë dorëzuar dokumentacionin e kompletuar sipas kriterëve dhe kërkesave të konkursit nuk do të merren parasysh.

II. Neni 37 i Rregullores 03/2021 përcakton se kandidati i cili e ka përfunduar provimin dhe trajnimin fillestar mbi arsimimin ligjor të organizuar nga ish Instituti Gjyqësor i Kosovës i nënshtrohet vetëm intervistës me gojë dhe procesit të vlerësimit të integritetit personal dhe aftësive profesionale, siç përcaktohet me Rregulloren. Provimi dhe trajnimi fillestar mbi arsimimin ligjor i organizuar nga ish Instituti Gjyqësor i Kosovës, siç përcaktohet në paragrafin 1 të nenit 37, do të llogaritet me dy të tretën (2/3) e maksimumit të pikëve, të dy (2) pjesëve të para të provimit, respektivisht testit kualifikues dhe testit me shkrim. Kandidati me pëlqimin dhe kërkesën e tij, mund t'i nënshtrohet procesit të rekrutimit që nga fillimi, sipas procedurave të përcaktuara me rregullore.

#### FORMULARI I APLIKIMIT

- formulari mund të shkarkohet nga faqja zyrtare e KGJK-së. ([www.gjyqesori-rks.org](http://www.gjyqesori-rks.org))

Shkarko Aplikacionin

#### AFATI I DORËZIMIT TË APLIKACIONEVE

Afati për dorëzimin e aplikacionit është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga publikimi i konkursit:


Data e fillimit të aplikimi: 11 MARS 2024  
Data e fundit të aplikimit: 25 MARS 2024

#### ADRESA:

- Sekretariati i KGJK-së,
- Rruga "Luan Haradinaj" nr. 133, Prishtinë, në Zyrën e Pranimit.
- 10000 Republika e Kosovës



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUJSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PRISHTINË - A



Sudski savet Kosova, u skladu sa članom 108. Ustava Republike Kosovo, Zakonom o Sudskom savetu Kosova br. 06/L-055, Zakonom o sudovima br. 06/L-054, Zakonom br. 08/L-015 o Privrednom sudu, Pravilnikom br. 03/2021 o regrutaciji, ispitu, imenovanju i ponovnom imenovanju sudija i Odlukom SSK-a br. 45/2024 od 22. februara 2024. godine, objavljuje:

#### JAVNI KONKURS ZA POZICIJU

#### SUDIJA

TRIDESET I DVE (32) POZICIJE  
za sudije na nivou osnovnih sudova  
i Privrednog suda – prvostepene komore

#### REGRUTACIJA KANDIDATA ZA SUDIJE

- Savet, putem ovog javnog obaveštenja, poziva sve kvalifikovane pravne stručenjake da se prijave za poziciju sudije u Osnovnim sudovima Republike Kosovo.
- Prilikom regrutacije kandidata, Savet će, između ostalih, uzeti u obzir sledeće kriterijume:

#### KRITERIJUMI I KVALIFIKACIJE

- Da bi se imenovali za sudiju, kandidati moraju, kao što je predviđeno članom 104. i članom 108. Ustava Republike Kosovo, ispunjavati sledeće opšte uslove:

- da su državljanini Republike Kosovo;
- imaju važeću diplomu Pravnog fakulteta u Republici Kosovo;
- da imaju položen pravosudni ispit prihvaćen prema zakonu koji se primenjuje u Republici Kosovo;
- da imaju visoki profesionalni ugled i lični integritet;
- da nisu osuđivani za krivično delo, osim za krivična dela izvršena iz nehata;
- da ima najmanje tri (3) godine radnog iskustva u pravnoj oblasti; i